



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

PLANI I VEPRIMIT 2011 PËR IMPLEMENTIMIN E PARTNERITETIT EUROPIAN PËR KOSOVËN



Mars 2011, Prishtinë

LISTA E SHKURTESAVE DHE AKRONIMEVE

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës
AB	Auditimi i Brendshëm
ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
ADR	Transportimi dhe Operimi i Materialeve të Rrezikshme
AENV	Akti Evropian i Ndërmarrjeve të Vogla
AKB	Aleanca Kosovare e Biznesit
AKMDhP	Agjencia Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
AKK	Agjencia Kosovare kundër Korrupsionit
AKK	Agjencia Kadastrale e Kosovës
AKI	Agjencia Kosovare e Intelegjencës
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës
AKPriv	Agjencia Kosovare e Privatizimit
AKS	Agjencia Kosovare e Standardizimit
APIK	Agjencia për Promovimin e Investimeve në Kosovë
APP	Agjencia për Prokurim Publik
ARBK	Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë
ARC	Keshilli Amerikan për Refugjate (<i>American Refugee Council</i>)
ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
ART	Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CEEPUS	Programi i Evropës Qendrore për Shkëmbim të Studimeve Universitare (<i>Central European Exchange Program for University Studies</i>)
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
CIECA	Komisioni Ndërkombëtar për Testim të Vozitjes (<i>The International Commission for Driver Testing</i>)
CITA	Komiteti ndërkombëtar për inspektimin e mjeteve të rënda motorike (<i>International Motor Vehicle Inspection Committee</i>)
DAK	Drejtorja e Akreditimit të Kosovës
DASHC	Departamenti i Administrimit të Shërbimit Civil
DHEK	Drejtorja për Hetime Ekonomike
DFID	Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar i Mbretërisë së Bashkuar (<i>UK Department for International Development</i>)
DMRAPIE	Departamenti për menaxhimin e reformës Administratës Publike dhe Integritetit Evropian
DK	Doganat e Kosovës
DPSA	Dialogun e Procesit të Stabilizimit Asociimit

EBRD

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (*European Bank for
Reconstruction and Development*)

LPP	Ligji mbi Prokurimin Publik
LPIS	Sistemi për identifikimin e parcelave të tokës (<i>Land Parcel identification system</i>)
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MAP	Ministria e Administratës Publike
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MIE	Ministria e Integrimit Evropian
MF	Ministria e Financave
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MI	Ministria e Infrastrukturës
NJDNJK	Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare

ReSPA	Shkolla Rajonale për Administratë Publike
RCC	Këshilli për Bashkëpunim Rajonal
RTK	Radio-Televizioni i Kosovës
SEETO	Observatori i Transportit për Evropën Juglindore
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar
SKE	Sekretariati i Komunitetit të Energjisë
SMIL	Sistemi i Menaxhimit Informativ të Lëndëve
SHKQAK	Shoqata e Kontabilistëve të Certifikuar dhe Auditorëve të <i>Ocur ty Str des Program)dev(AK)-03080s TdncoreknublBambnavimf InfcTelePt deve</i>

1. HYRJE	6
1.1. RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EVROPIAN	6
2. PLANI I VEPRIMIT PËR IMPLEMENTIMIN E PARTNERITETIT EVROPIAN - AFRIMI I KOSOVËS ME BE-në	8
3. ZBATIMI I PVPE-së 2010 DHE ADRESIMI I SFIDAVE TË RAPORTIT TË PROGRESIT	12
3.1. KRITERET POLITIKE	12
3.1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT	12
a. Institucionet	12
b. Administrata Publike.....	13
c. Sistemi gjyqësor	14
d. Politikat kundër korrupsion.....	14
3.1.2 TË DREJTAT E NJERIUT DHE MBROJTJA E MINORITETEVE	15
3.1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE	17
3.2 KRITERET EKONOMIKE	19
3.3. STANDARDET EVROPIANE	21
3.3.1. TREGU I BRENDSHËM	21
a. Lëvizja e lirë e mallrave	21
b. Lëvizja e lirë e kapitalit	22
c. Doganat dhe tatimet	22
d. Konkurrenca	23
e. Prokurimi publik	24
f. Të drejtat e pronësisë intelektuale	25
g. Punësimi dhe politikat sociale	26
h. Arsimi dhe kërkimet	27
3.3.2 POLITIKAT SEKTORIALE	28
a. Industria dhe NVM-të.....	28
b. Bujqësia dhe peshkataria	29
c. Mjedisi	31
d. Politikat e transportit	32
e. Energjia	33
f. Shoqëria informative dhe mediat.....	35
g. Kontrolli financiar	36
h. Statistikat	37
3.3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA	38
a. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi	38
b. Shpëlarja e parave	39
c. Drogat	39
d. Policia	40
e. Luftimi i krimit dhe krimit të organizuar	41
f. Mbrojtja e të dhënave personale	41
4. MATRICA E VEPRIMEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET EVROPIAN 2011	42

1. HYRJE

1.1. RAPORTET E REPUBLIKËS SË KOSOVËS ME BASHKIMIN EVROPIAN

Kosova, sikur edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, është pjesë e procesit të integrimit Evropian që nga *Samiti i Zagrebit*

saj në nismat për bashkëpunim rajonal, kurse gjatë këtij viti Kosova ka marrë kryesimin e radhës të CEFTA-së.

Në fushën e kriterëve ekonomike, Qeveria e Kosovës ka vazhduar ruajtjen e stabilitetit makroekonomik përmes mbajtjes së politikave fiskale stabile, progresin e mëtutjeshëm në forcimin e ekonomisë së tregut dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, përfshirë rishikimin e KASH-it dhe miratimin e legjislacionit përkatës në harmoni me i

identifikuara nga Partneriteti Evropian 2008.³ Përparimi i mëtutjeshëm i vendit do të matet në bazë të zbatimit të prioriteteve kyçe, afatshkurta dhe afatmesme, në kuadër të Partneritetit Evropian përmes Raportit të përvitshëm të Progresit nga Komisioni Evropian. Në këtë kontekst, PVPE-ja duhet të përdoret për planifikimin e veprimtarisë së përgjithshme të Qeverisë në lidhje me agjendën politike dhe prioritetet e saj, agjendën legjislative të Qeverisë dhe të Kuvendit, nevojat për punësim, ndërtimin institucional dhe trajnimin e personelit si dhe investimet e nevojshme.

Gjithashtu PVPE-ja duhet të përdoret për komunikim të brendshëm të Qeverisë me qëllim të harmonizimit të objektivave, veprimeve dhe afateve brenda saj; për komunikim mes Qeverisë dhe komunitetit afarist dhe partnerëve social si mekanizëm informues dhe paralajmërues për ndryshimet që do të ndodhin dhe të cilat prekin ato; për komunikim me shoqërinë civile si bazë për ndërtimin e partneritetit; dhe për komunikim me publikun e gjerë në mënyrë që qytetarët të jenë të informuar në çdo kohë për punën e Qeverisë në procesin e integritimit evropian.

Plani ndjek strukturën e Partneritetit Evropian për Kosovën 2008 si dhe është në pajtim me kriteret e Kopenhagës dhe Madridit dhe përmban tre kapituj kryesor: **Kriteret Politike, Kriteret Ekonomike dhe Standardet Evropiane**. Në secilin kapitull, varësisht nga progresi i arritur në ato fusha dhe nevojat për përmirësimin e situatës në të ardhmen, janë paraparë veprime të cilat kanë të bëjnë me sigurimin dhe përmirësimin e politikave strategjike dhe legjislacionit, re spektivisht harmonizimi në mëtutjeshëm të kornizës ligjore vendore me *Acquis*, hartimin dhe miratimin e legjislacionit të ri të nevojshëm dhe veprime të cilat fokusohen në implementimin e legjislacionit në fuqi, reformën institucionale, zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, investimet kapitale, etj.

PVPE 2011 ka gjithsej rreth 400 veprime, prej tyre 60 veprime janë paraparë në fushën e kriterëve politike, 50 veprime në fushën e kriterëve ekonomike dhe 290 për standardet evropiane. Me qëllim që PVPE-ja të jetë një dokument më i matshëm dhe më praktik, këtë vit janë përcaktuar edhe indikatorët matës në nivel të veprimeve. Meqenëse ky është një element i ri i këtij Plani, shumë i rëndësishëm për matjen e implementimit të PVPE, si hap i parë në këtë drejtim, këtë vit janë përcaktuar vetëm indikatorët e kontributit/ *inputit* (veprimet dhe buxheti) dhe indikatorët e produktit/ *outputit*, për të vazhduar në të ardhmen edhe me përcaktimin e indikatorëve për prioritetet, respektivisht indikatorët e rezultatit (*outcome*) dhe indikatorët e efekteve (*impact*). Vlen të theksohet se është shënuar progres në përllogartijen e kosotos së PVPE 2011 dhe lidhjen e tij me buxhetin. Kostoja e totale e PVPE 2011 është vlerësuar të jetë rreth 1,284,092,652.57 €, ku 919,389,065.81 € planifiket të mbulohe nga BKK, 82,977,585.09 € planifikohet të mbulohe nga donatorët, ndër sa 281,726,001.67 € është vlerësuar të jetë mungesa (zbrazëtira).

³ Prioritetet e Partneritetit Evropian janë ndarë në prioritetet afatshkurtra (1-2 vite) dhe prioritetet afatmesme (3-4 vjet). Prioritetet afatshkurtra – përshkruajnë veprimet që do të zbatohen vis-a-vis prioriteteve afatshkurtra brenda secilës fushë, kurse prioritetet afatmesme – përshkruajnë veprimet që do të zbatohen vis-a-vis prioriteteve afatmesme brenda secilës fushë.

Duke pasur parasysh rëndësinë prioritare të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, si një dokument kryesor mbarë qeveritar për integrim evropian, rishikimi i këtij plani ka marrë parasysh prioritetet e Qeverisë dhe programin e saj (draft), draft buxhetin Kornizën Afat-mesme të Shpenzimeve, Strategjitë e ndryshme sektoriale dhe planet e veprimit, rekomandimet e Raportit të Progresit të Komisionit Evropian dhe rekomandimet e Dialogut të Procesit të Stabilizim Asociimit. Sa i përket rekomandimeve dhe sfidave të identifikuara nga Komisioni i Evropian, PVPE 2011 merr parasysh dhe adreson sfidat e Raportit të Progresit 2010 dhe rekomandimet e të gjitha takimeve sektoriale dhe takimit plenar të DPSA-së. Me qëllim të monitorimit dhe të adresimit të duhur të rekomandimeve në fjalë, gjatë vitit 2011, pasi të jenë miratuar konkluzionet e çdo takimi të DPSA-së, Qeveria e Kosovës menjëherë do të parasheh veprime konkrete për adresimin e tyre dhe do t'i përfshijë ato në kuadër të sistemit për monitorimin dhe raportimin e PVPE.

Për të ruajtur koherencën e adresimit të prioritetëve të dala nga dokumente të ndryshme të Bashkimit Evropian për Kosovën, gjatë rishikimit të PVPE, Qeveria e Kosovës ka paraparë veprime të cilat marrin parasysh të gjitha prioritetet që dalin nga procesi i integritit evropian. Gjatë procesit të ri shikimit, është vërejtur që një numër i prioritetëve, apo pjesë të tyre janë realizuar dhe tani më mund të llogariten si prioritate të vjetruara. Si rezultat në fusha të caktuara janë paraparë veprime të cilat nuk adresojnë drejtpërdrejtë prioritetet e Partneritetit Evropian, por të cilat veprime adresojnë sfida të caktuara që janë identifikuar nga Raporti i Progresit apo Dialogu i Procesit të Stabilizim-Asociimit, të dy këto instrumente shumë të rëndësishme për afrimin e Kosovës drejt Bashkimit Evropian. Në këtë aspekt gjithashtu mund të hasen prioritate për të cilat nuk janë paraparë fare veprime për arsye se ato prioritate tani më janë të realizuara apo të cilat brenda kornizës së përgjithshme të prioritetëve që dalin nga procesi i integritit evropian të Kosovës janë më pak relevante apo janë adresuar në prioritetet të tjera afatshkurta ose afatmesme. Në këtë aspekt është shumë e rëndësishme të theksohet nevoja e rifreskimit të prioritetëve të Partneritetit Evropian me qëllim të ruajtjes së koherencës së prioritetëve të BE-së për Kosovën dhe si rezultat edhe planifikimit më koherent të Kosovës për adresimin e tyre.

Sa i përket monitorimit të implementimit të Planit të Veprimit të Partneritetit Evropian, Ministria e Integritit Evropian gjatë vitit 2010 ka lansuar dhe funksionalizuar sistemin elektronik për monitorim dhe raportim të PVPE-së. Gjatë vitit 2010 ky sistem është shfrytëzuar për marrjen e raporteve në baza tremujore nga secili institucion i cili ka bartur mbi vete veprime konkrete në kuadër të PVPE 2010. I njëjti sistem do të përdoret edhe gjatë vitit 2011 për monitorimin e implementimit të PVPE i cili gjithashtu do të përdoret edhe për monitorimin e implementimit të rekomandimeve të dala nga Dialogu i Procesit të Stabilizim Asociimit.

Në këtë aspekt është me rëndësi të theksbet edhe roli i grupeve punuese për integrim evropian, të cilat edhe pse me vështirësi të mëdha kanë luajtur rol të rëndësishëm në aspektin e monitorimit, rishikimit dhe miratimit të këtij plani. Për më të tepër, Ministria e Integritit Evropian në bashkëpunim të ngushtë me Projektin e Binjakëzimit të Komisionit Evropian, ka filluar rishikimin funksional të këtyre grupeve. Në funksion të rritjes së punës efektive dhe përmirësimit të performancës së tyre, është hartuar

manuali operativ për këto grupe punuese dhe janë mbajtur trajnimet e nevojshme të të gjitha palëve të përfshira në këto grupe për këtë manual. Më tej, gjithashtu shumë shpejt do të bëhet edhe harmonizimi përmbajtësor i këtyre grupeve me strukturën e takimeve të DPSA-së me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe kontributit të këtyre grupeve punuese në procesin e implementimit të prioritetve të Bashkimit Evropian për Kosovën.

3. ZBATIMI I PVPE-së 2010 DHE ADRESIMI I SFIDAVE TË RAPORTIT TË PROGRESIT

3.1. KRITERET POLITIKE

3.1.1 DEMOKRACIA DHE SUNDIMI I LIGJIT

a. Institucionet

Forcimi i institucioneve bazë për sigurimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit ka mbetur prioritet i të gjithë institucioneve të Republikës së Kosovës edhe gjatë vitit 2010.

b. Administrata Publike

Gjatë vitit 2010, reforma e administratës publike ka vazhduar të mbetet si prioritet kyç i Qeverisë së Kosovës. Nivel i konsiderueshëm progresi është shënuar në kompletimin e kornizës ligjore për sigurimin e një administrate publike efikase dhe moderne, përmes miratimit të Ligjit për Shërbimin Civil dhe atij për Pagat e Nëpunësve Civilë. Kjo kornizë ligjore është përmirësuar tutje edhe me miratimin e ligjeve që rregullojnë kontestet administrative si dhe administratën shtetërore.

Për më tepër, për të plotësuar edhe kornizën e politikave në këtë fushë është miratuar Strategjia e rishikuar për Reformën e Administratës Publike 2010-2013, e cila mbulon masat që planifikohen të ndërmerren sa i përket menaxhimit të politikave, hartimit të legjislacionit, etikës dhe transparencës, komunikimit me qytetarë, planifikimit buxhetor, ekzekutimit të buxhetit, kontrollit dhe auditimit të brendshëm, prokurimit publik, organizimit të administratës publike, racionalizimit të proceseve elektronike administrative dhe qeverisë elektronike.

Gjithashtu, kanë përfunduar rishikimet funksionale në rrafshin horizontal dhe vertikal të institucionve me qëllim të evitimit të dyfishimit dhe paqartësive në ndarjen e detyrave dhe përgjegjësi. Si rezultat i rekomandimeve të dalta nga këto rishikime Ministria e Administratës Publike, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministria e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit dhe Instituti Kosovar për Administratë Publike kanë hartuar, aprovuar dhe janë në implementim e sipër të planeve zhvillimore strategjike.

Pasi që reformimi i administratës publike dhe modernizimi i saj përfshinë një numër të madh palësh të interesuara, gjatë vitit 2010 në një masë janë fuqizuar kapacitetet e Departmentit për Menaxhimin e Reformës së Administratës Publike dhe Integrimi Evropian në kuadër të MAP-së. Një masë etilë pritet të rrisë shkallën e koordinimit ndër-institucional drejt implementimit të këtyre reformave.

Edhe pse ka pasur një numër të rëndësishëm masash të ndërmarra, sfida në këtë sektor sidomos në drejtim të implementimit të legjislacionit të ri për shërbimin civil, mbetet avancimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, implementimi i Strategjisë së rishikuar të Reformës së Administratës Publike 2010-2013 si dhe zbatimi i rishikimeve funksionale.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave të mbetura, Plani i tanishëm parasheh masa të mëtejme ligjore dhe të ndërtimit të kapaciteteve si në drejtim të zbatimit të legjislacionit kornizë për shërbimin civil, përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, por poashtu edhe në drejtim të zbatimit të Strategjisë së rishikuar për Reformën e Administratës Publike 2010-2013 dhe rezultateve të rishikimit funksional për të gjitha institucionet (për më shumë shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 19-22).

c. Sistemi gjyqësor

Një sistem gjyqësor efikas dhe i pavarur paraqet një ndër kushtet kryesore në drejtim të sigurimit të sundimit të ligjit. Kosova ka shënuar progres të rëndësishëm në reformimin e sistemit të saj gjyqësor gjatë vitit 2010 përmes miratimit të kornizës ligjore për gjykatat, prokuroritë, si dhe për mekanizmat që me naxhojnë ato siç janë Këshilli Gjyqësor i Koëovës, dhe ai Prokurorial. Për më shumë, ka përfunduar edhe emërimi/ri-emërimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve në nivel vendi, më ç'gjë është siguruar shkallë më e lartë e paanshmërisë, efektshmërisë dhe pavarësisë së gjyqësorit. Në ndërkohë, është themeluar Këshilli Prokurorial i Kosovës i cili do të menaxhojë prokuroritë, përzgjedhjen e prokurorëve dhe ekzekutimin e masave eventuale disiplinore ndaj prokurorëve. Gjithashtu, është rritur niveli i bashkëpunimit të bashkëpunimit të prokurorëve dhe agjencive për zbatimin e ligjit, kurse rritja e pagave dhe si gurisë për gjykatësit dhe prokurorët pritet të ndikojë në ngritjen e mëtejme të kapacitetit dhe motivimit të gjyqësorit kosovar. Më tej, është shënuar progres edhe në drejtim të përmirësimit të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, përmes nënshkrimit të marrëveshjeve me shtete të ndryshme në këtë fushë.

Me gjithë progresin e shënuar, mbetet një numër jo i vogël i sfidave në këtë sektor, duke përfshirë sigurimin e implementimit të legjis lacionit të miratuar, planifikimit zhvillimor në kuadër të reformës së gjyqësorit, ngritjes së kapacitetit menaxhues të këtij sektori, dhe rritjes së efektshmërisë për të zvogëluar numrin e rasteve të pashqyrtuara.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, ky Plan Veprimi, parasheh që të ndërmerren masa në drejtim të kompletimit të kornizës ligjore me miratimin e Kodit Penal dhe atij të Procedurës Penale, implementimit në gjykata dhe prokurori përmes ristrukturimit të tyre, transferit të funksionit të përzgjedhjes nga KPGJP tek KGJK dhe KPK, si dhe ngritjes së mëtejme të kapaciteteve në këto institucione. Ky plan parasheh gjithashtu edhe përmirësimin e bashkëpunimit juri dik ndërkombëtar përmes avancimit të legjislacionit përkatës, sikurse edhe bashkëpunimin ndër-institucio nal dhe përmirësimin e infrastrukturës për gjykata dhe prokurori (për më shumë shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 23-27).

d. Politikat kundër korrupsion

Edhe gjatë vitit 2010, luftimi i korrupsionit ka mbetur lartë në listën e prioriteteve të Qeverisë së Kosovës dhe institucioneve tjera. Kështu, gjatë kësaj kohe është përmirësuar korniza ligjore në këtë fushë përmes miratimit të Ligjit për Financimin e Partive Politike, Ligjit për Konfliktin e Interesit si dhe atij për Agjencinë Kundër Korrupsion. Për më tepër është përmirësuar edhe korniza e politikave përmes miratimit të Planit të Veprimit Kundër Korrupsionit. Gjatë kësaj kohe është bërë deklarimi i pasurisë së zyrtarëve të lartë publik duke bërë publikimin e këtyre deklarave në ueb-faqen zyrtare të Agjencisë

Për më tepër, është përmirësuar edhe korniza institucionale në luftimin e korrupsionit duke themeluar Agjencinë për Menaxhimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar, krijimin e task-forcës anti-korrupsion në Zyrën e Prokurorisë Speciale, si dhe Drejtorisë për Krim Ekonomik dhe Anti-Korrupsion br enda Policisë së Kosovës. Gjithashtu,

përmirësuar bashkëpunimi ndër-institucional në luftimin e korrupsionit, sidomos në mes të agjencive për zbatimin e ligjit. Agjencitë për zbatimin e ligjit, kanë ndërmarrë masa edhe për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit përbrenda tyre, gjë që ka çuar në një numër hetimesh që në disa raste kanë rezultuar me suspendim.

Megjithatë, një numër sfidash mbeten në këtë sektor, si në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të legjislacionit, rritjes së shkallës së kapaciteteve institucionale dhe bashkëpunimit ndër-institucional, ashtu edhe në promovimin e politikave sektoriale parandaluese në luftimin e korrupsionit.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, ky Plan Veprimi parasheh, përmirësimin e kornizës ligjore përmes rishikimit dhe miratimit

Komisionit për Ndhmë Juridike Falas dhe Odës së Avokatëve, Ministrisë së Drejtësisë dhe Gjykatave për mbikqyrjen e dënimeve për të mitur, si dhe në mes të Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Policisë në drejtim të implementimit të urdhëresave për dëbime (në fushën e të drejtave pronësore).

Edhe pas gjithë këtij angazhimi, mbetet një numër sfida në këtë sektor, e sidomos për sa i përket çësjes në drejtësi të viktimave, kushtëteve në burgje, përket

Gjatë vitit janë kthyer 1600 pjestarë të komunitetit pakicë, përderisa parcela të tokës u janë shpërndarë të kthyerve të papronë, si dhe mbahen linja autobusi pa pagesë për komunitetet jo-shumicë. Një zhvillim i mi rëpritur është edhe miratimi i Planit Operacional për kampet në Cesmin Lug dhe Osterode, ku është shënuar progres në zhvendosjen e familjeve nga këto kampe.

Me gjithë angazhimin e treguar, mbetet një numër sfidash si në drejtim të adresimit të kapaciteteve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ashtu edhe në drejtim të përmirësimit të harominizimit të institucioneve relevante që merren me çështjet e komuniteteve, por edhe në fushën e përdorimit të gjuhëve. Problemet rëndohen edhe më shumë nga situata jo e përshtatshme ekonomike, sidomos për pjestarët e komunitetit RAE, sikurse edhe nga sfidat në riintegrimin e tyre si në kuadër të procesit të kthimit vullnetar apo atij të detyruar. Sfidë shtesë paraqet edhe konsolidimi i kornizës strategjike për rregullimin e vendbanimeve joformale.

Me qëllim të adresimit të disa prej këtyre sfidave, ky Plan Veprimi parasheh masa në drejtim të rritjes së numrit të pjestarëve jo-shumicë në të gjitha nivelet institucionale, rritjen e qasjes në arsim si dhe në shërbime shëndetësore. Gjithashtu, parashihen masa për përmirësimin e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore si dhe përdorimit të gjuhëve. Për më shumë, janë planifikuar edhe masa shtesë për rregullimin e vendbanimeve jo-formale si dhe për implementimin e kornizës ligjore dhe strategjike për kthim vullnetar (ë shumë shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 44-47).

3.1.3 ÇËSHTJET RAJONALE DHE OBLIGIMET NDËRKOMBËTARE

Progresi i shënuar në kuadër të bashkëpunimit rajonal konsiston kryesisht në pjesëmarrjen e Kosovës në nismat për bashkëpunim rajonal, siç është Këshilli për Bashkëpunim Rajonal si dhe Takimi i Nivelit të Lartë BE – Ballkan Perëndimor. Për më tepër, Kosova vazhdon të përfshihet në të gjitha obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë, Marrëveshja për Hapësirën për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore (CEFTA), Marrëveshja mbi Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), Observatorin e Transportit për Evropën Juglindore (SEETO).

Më tej përveç sfidave serioze në kuadër të CEFTA-së, kryesimin e radhës së të cilës e mban gjatë këtij viti, sfiduese mbetet edhe përfshirja e plotë në Këshillin për Bashkëpunim Rajonal (RCC) dhe Shkollën Rajonale për Administratë Publike (ReSPA): megjithëse vazhdon të përfshihet në aktivitetet e tyre, barriera të natyrës politike (për shkak të mosnjohjes nga një numër i vogël shtetesh fqinje) vazhdojnë të pengojnë seriozisht që Kosova të jetë pjesë e barabartë dhe të përfitojë nga RCC, ndërkohë që me përfundimin e tranzicionit të ReSPA-së në një institucion në pronësi rajonale, Kosova është e detyruar të gjejë zgjidhje alternative *ad hoc*, pa u bërë anëtar me të drejta e obligime të plota i kësaj iniciative. Gjitha shtu ka vazhduar përfshirja, në rolin e vëzhguesit, në Kompaktin për Investime për Evropën Juglindore, e cila është projektuar për të përmirësuar klimën e investimeve dhe për të inkurajuar zhvillimin e sektorit privat në rajon.

Për adresimin e sfidave në këtë fushë, ky Planparasheh sidomos aktivitete që kanë të bëjnë me kompletimin e kornizës strategjike për bashkëpunim rajonal, si dhe masa për vendosjen e kornizës ligjore, strategjike dhe institucionale që mbulon fushat kyçe sektoriale relevante për bashkëpunimin rajonal: tregtinë, energjinë, aviacionin civil, bashkëpunimin ndër-kufitar dhe administra tën publike (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 48-49).

3.2 KRITERET EKONOMIKE

Në funksion të forcimit të ekonomisë së tregut, Qeveria ka vazhduar të ketë si prioritet stabilitetin makroekonomik dhe ndërveprimin e forcave të tregut edhe gjatë vitit 2010. Në këtë drejtim, Qeveria ka aprovuar Kornizën e rishikuar Afatmesme të Shpenzimeve 2011-2013 si dhe ka nënshkruar marrëveshje parë me Fondin Monetar Ndërkombëtar në funksion të ruajtjes së stabilitetit fiskal.

Institucionet përkatëse kanë punuar në drejtim të mbajtjes së politikave fiskale stabile dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike, përfshirë këtu edhe miratimin e legjislacionit primar e sekondar, si dhe pakos së ligjeve të rishikuara si pjesë e përmbushjes së veprimeve paraprake për nënshkrim të programit me FMN⁴. Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka vazhduar konsultimet dhe raportimet e rregullta para Mekanizimit të Mbikëqyrjes Fiskale me Komisionin Evropian, mekanizëm ky i cili e analizon dhe shqyrton të gjitha politikat me ndikim fiskal. Ka vazhduar procesi i privatizimit dhe kontributi për të forcuar mekanizmat për përmirësimin e qeverisjes dhe qëndrueshmërisë financiare të NP-ve. Në këtë kuadër, është implementuar vendimi për riemërimin e 120 Komiteteve për likuidimin e Ndërmarrjeve Shoqërore si dhe komisionet për likuidim kanë filluar përgatitjet për likuidim dhe shitje të aseteve.

Me qëllim të rritjes së aftësisë konkurruese në treg dhe promovimit të ambientit të favorshëm për biznes, ka vazhduar puna për forcimin e të drejtave pronësore. Gjatë vitit të kaluar janë implementuar 173 vendime për të gjitha format e implementimit (riposedim, administrim, mbyllje me kërkesë të palës) si dhe janë kryer 426 dëbime nga pronat.⁵ Gjithashtu, Autoritetet rregullative kanë shënuar progres në drejtim të ngritjes dhe zgjerimit të kapitalit njerëzor përmes trajnimeve dhe avancimit profesional. Ka pasur progres në forcimin e mekanizmave rregullativ në funksion të tregut dhe konkurrencës përfshirë këtu edhe nënshkrimin e kontratës për partneritet publiko-privat për operator të Aeroportit të Prishtinës. Në fushën e arsimit, ka vazhduar procesi i akreditimit dhe licencimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe është bërë klasifikimi i niveleve në pajtueshmëri me kornizën e kualifikimeve evropiane.

Përveç progresit të arritur në forcimin e ekonomisë së tregut dhe stabilitetit makroekonomik dhe ndikimit të limituar të krizës financiare botërore në Kosovë, mbetet sfida forcimi i lidhjes në mes të politikave prioritare, reformave strukturale dhe shpenzimeve publike. Për më tepër, zvogëlimi i disbalancit të jashtëm dhe papunësisë mbeten sfida komplekse që ndërlidhen edhe me rritjen e konkurrueshmërisë dhe të avancimit të mëtutjeshëm të kapitalit njerëzor.

Zhvillimi i mëtutjeshëm i kornizës ligjore dhe zbatimi i ligjeve mbetet sfida sja Tw 19. 9Pkrishtin

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, Plani i veprimit përfshin një varg aktivitete për vitin 2011. Ky plan synon të adresojë stabilitetin e financave publike e politikave fiskale, përmirësimin e qeverisjes dhe rritjen e efikasitetit të NP-ve. Plani gjithashtu përfshin vazhdimësinë e procesit të privatizimit me fokus të veçantë në forcimin e qeverisjes dhe reduktimin e ndihmave në sektorin publik. Pjesë e realizimit të këtij qëllimi është edhe privatizimi i PTK-së dhe Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe

3.3. STANDARDET EVROPIANE

3.3.1. TREGU I BRENDSHËM

a. Lëvizja e lirë e mallrave

Në kuadër të infrastrukturës së cilësisë është arritur që të zgjerohet korniza ligjore në fushën e metrologjisë dhe standardizimit ⁶ dhe është vazhduar me zbatimin e Strategjisë për Zhvillimin e Infrastrukturës së Metrologjisë. Gjatë vitit 2010 Drejtoria e Kosovës për Akreditim (DAK) është anëtarësuar në dy organizata rajonale dhe ndërkombëtare (IAF dhe ILAC) dhe është arritur statusi i anëtares me kontratë në Korporatën Evropiane të Akreditimit. Më tej janë themeluar 4 laboratorë të rinj dhe janë krijuar 17 komitete të reja teknike dhe është rritur numri i standardeve. ⁷ Sa i përket mbikëqyrjes së tregut, gjatë vitit 2010 është përmirësuar korniza ligjore me miratimin e Ligjit për Inspektoratin e Tregut dhe rëndësi e veçantë i është dhënë zbatimit të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit 2010- 2014.

Edhe përkundër një numri të arriturash, infrastruktura e cilësisë përballet me shumë sfida. Sfidë kryesore për Departamentin e Metrologjisë mbetet anëtarësimi në organizatat evropiane dhe ndërkombëtare të metrologjisë⁸. Njëkohësisht, në mënyrë me specifike, kërkohet që në të ardhmen të punohet në drejtim të zhvillimit të metrologjisë industriale. Fusha e standardizimit vazhdon të sfidohet në pamundësinë e anëtarësimi në ISO për arsye se kjo kushtëzohet meanëtarësimin e Kosovës në OKB. Drejtoria e Akreditimit për të zgjeruar aktivitetin e saj ka nevojë të rris numrin e Trupave për Vlerësimin e Konformitetit. Sa i përket Inspektoratit të Tregut sfida për të ardhmen vazhdon të mbetet zbatimi i Ligjit të ri për Inspektoratin e Tregut i shoqëruar me legjislacionin sekondar të fushës, si dhe me nevojën për të miratuar Strategjinë për Mbikëqyrjen e Tregut. Njëkohësisht, në drejtim të mbikëqyrjes së tregut do të vazhdohet të punohet në zbatimin korrekt të Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit 2010-2014. Në fushën e tregtisë, si sfida kryesore ende mbetet mosnjohja e vulës doganore të

dhe do të vazhdohet me implementimin e Programit për Mbrojtjen e Konsumatorit 2010-2014. Është paraparë të punohet edhe në drejtim të përmirësimit të strukturave organizative të brendshme për këtë fushë, duke u bazuar në praktikat më të mira në rajon dhe në vendet anëtare të UE-së. Mëtej në fushën e tregtisë, Qeveria e Kosovës përveç që do të punoj maksimalisht në kryesimin e CEFTA-së, gjithashtu planifikon të punoj në heqjen e barrierave jo-tarifore dhe barrierave tarifore si dhe do të koncentrohet në monitorimin e zbatimit të termave që dalin nga kjo marrëveshje (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 48, 55, 126 dhe 127).

b. Lëvizja e lirë e kapitalit

Gjatë vitit 2010 u konfirmua se ekziston regjim liberal lidhur me lëvizjen e kapitalit. Nivel i konsiderueshëm progresi është shënuar në rritjen e investimeve direkte të huaja krahasuar me vitin 2009, vit ky i prekur nga kriza globale.

Përveç kësaj progresi i ndjeshëm është arritur në sistemin e pagesave. Në këtë drejtim Bordi i Bankës Qendrore miratoi Strategjinë Nacionale të Pagesave që përqendrohet në implementimin e sistemit të pagesave për shlyerje bruto në kohë reale (RTGS). Në kuadër të saj përfshihet edhe vlerësimi i sistemeve aktuale të pagesave.

Nivel i konsiderueshëm progresi është arritur me hyrjen në fuqi të Ligjit për Bankën Qendrore përderisa korniza ligjore do të kompletohet me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Ligjit për Bankat, Ligjit për Transaksionet e Pagesave, Ligjit për sigurimet, Projektligjit për sigurimet e detyrueshme të auto përgjegjësisë ndaj palëve të treta, Ligjit për Sigurimet e përgjithshme dhe Ligjit për Fondin Pensional të Kosovës.

Ka pasur një numër të konsiderueshëm të masave të ndërmarra në drejtim të zbatimit të principeve bazë të komitetit të Baselit për rregullim dhe mbikëqyrje efektive bankare. Është draftuar korniza e rregullative ndaj bankave duke inkorporuar standardet më të reja të kohës dhe të direktivave evropiane në licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave të mbetura, Plani i tanishëm i Partneritetit Evropian parasheh një sërë masash të mëtejme. BQK parasheh krijimin e njësisë për letrat me vlerë, mbikëqyrjen financiare në përputhje me Basel II dhe Solvenca II si dhe zhvillimin e sistemeve ndër-bankare për ofrimin e shërbimeve bankare efektive për klientë (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioriteti 56).

c. Doganat dhe tatimet

Doganat e Kosovës gjatë vitit 2010 kanë vazhduar me trendin pozitiv të mbledhjes së të hyrave, u ka pasur rritje 10.3% në krahasim me vitin 2009. Gjithashtu edhe Administrata Tatimore e Kosovës gjatë vitit 2010 ka vazhduar me trendin pozitiv të mbledhjes së të hyrave ku ka realizuar rritje prej 7% në krahasim me vitin 2009.

Me këtë Doganat dhe Administrata Tatimore kanë arritur që të rrisin efikasitetin e tyre në mbledhjen e të hyrave. Në kuadër të politikave Tatimore, ATK gjatë vitit 2010 ka

vazhduar me lëshimin e numrave fiskal për bi znese dhe persona fizik si dhe pajisjen dhe instalimin e arkave fiskale për biznese, duke ndikuar në rritjen e trendit të të hyrave nga tatimet dhe në zvogëlimin e evazionit fiskal.

Për më tepër, për të plotësuar Kornizën Ligjore në këto dy institucione, është punuar në miratimin e legjislacionit primar dhe atij sekondar duke mundësuar ngritjen profesionale dhe ristrukturimin e këtyre dy institucioneve. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve janë punësuar dhe trajnuar zyrtarë shtesë, që ka ndikuar në fuqizimin e mekanizmave për mbledhjen e të hyrave buxhetore dhe në koordinimin më të mirë të politikave për luftimin e krimit të organizuar si dhe në zhvillimin e planeve të inkasimit të borxheve.

Edhe pse ka pasur një numër të rëndësishëm masash të ndërmarra, sfida për këto institucione mbasin zbatimin e legjislacionit. Fushat specifike që kërkojnë vëmendje janë lufta kundër kontrabandës dhe falsifikimit, poashtu është e nevojshme të bëhen përpjekje shtesë për të siguruar zbatimin efektiv të legjislacionit, zbatimin e pagesave tatimore dhe zvogëlimin e ekonomisë joformale. Edhe pse është shënuar progres në bashkëpunimin me shtetet tjera në këtë fushë përmes arritjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit, sfida në të ardhmen mbetet mosnjohja e vulave Doganore nga Serbia dhe Bosnja e Hercegovina gjë që vështirëson efikasitetin në doganim dhe tatim.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave të mbetura, Plani i tanishëm parasheh hapa të mëtutjeshëm në forcimin e legjislacionit primar dhe atij sekondar, si në fushën e Doganës poashtu edhe në atë Tatimore, që do të ndikojnë në implementimin më efektiv të politikave dhe strategjive për këto institucione. Në këtë aspekt vëmendje e veçantë edhe këtë vit do t'i kushtohet ngritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe bashkëpunimit me vendet tjera sidomos në fushën e doganave. Kurse në fushën e tatimeve përveç tjerash vëmendje e veçantë do t'i kushtohet arritjes së marrëveshjeve për eliminimin e tatimeve të dyfishta me vendet tjera, e cila do të rezultojë me rritjen e investimeve në mes tyre.

Me qëllim të ngritjes së nivelit të shërbimeve të ofruara dhe përmirësimin e përpunimit të të dhënave si në Dogana po ashtu edhe në Administratën Tatimore, prioritet do t'i jepet ngritjes dhe përmirësimin të teknologjisë informative. Edhe këtë vit, ATK-ja do të vazhdojë me lëshimin e numrave fiskal dhe funksionalizimin e arkave fiskale me qëllim të evitimit të evazionit fiskal dhe luftimit të ekonomisë joformale e cila përbën një prioritet të veçantë për Qeverinë e Kosovës këtë vit (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 57, 59, 128)

d. Konkurrenca

Komisioni Kosovar i Konkurrencës (KKK) ka kompletuar kornizën ligjore me amendamentimin e Ligjit mbi Konkurrencën dhe ka vazhduar me hulumtimin e rasteve të shkeljes së konkurrencës lojale. KKK gjithashtu ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me vendet e rajonit, si dhe është bërë anëtar i Rrjetit Ndërkombëtar të Konkurrencës.

Kjo sferë vazhdon të sfidohet me numër të pamjaftueshëm të kuadrove për hulumtimin në kuadër të tri shtyllave kryesore të konkurrencës: kartelet, shfrytëzimi i pozitës dominuese dhe përqendrimet.

KKK planifikon që gjatë vitit 2011 të hartoj dhe mi ratoj legjislacionin e saj sekondar dhe të vazhdojë me hulumtimin e rasteve të reja të dyshuara për veprimtari anti-konkurrencë (për më shumë detaje shih tabelëne veprimeve, Prioriteti 55).

f. Të drejtat e pronësisë intelektuale

Kjo fushë, edhe pse ka pasur progres, i njëjti ka qenë mjaft i kufizuar dhe i varur kryesisht nga kapacitetet njerëzore, pasi që Institucionet përgjegjëse për rregullimin dhe avancimin e fushës kanë mungesë të dukshmetë tij. Zyra për Pronësi Industriale pranë MTI-së ka ngritur kapacitetet teknike të saj përmes rekrutimit të stafit të ri dhe njëkohësisht ka pasur edhe ngritje profesionale të stafit përmes një numri trajnimesh dhe vizitash studimore për stafin e institucioneve të përfshira në këtë fushë. Në anën tjetër, gjatë vitit 2010 është themeluar edhe Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në kuadër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, ku janë caktuar zyrtarë me përvojë për ngritje të Zyrës dhe kapaciteteve operacionale të saj, dhe me qëllim të përkrahjes së autorëve në vendosjen e sistemitë menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorit dhe të drejtave tjera të përafërta. Gjatë këtij viti, është miratuar edhe Strategjia për Pronësi Intelektuale 2010/2014 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e strategjisë me qëllim të koordinimit të veprimeve ndër institucionale në fushën mbrojtjes dhe respektimit të pronës intelektuale në përputhshmëri me standardet e aplikuara në BE dhe ato ndërkombëtare. Poashtu, edhe disa institucione tjera të përfshira në këto procese⁹ kanë ngritur aktivitetet e tyre në kuadër të kësaj fushe, me ç'rast niveli i mbrojtjes dhe respektimit të pronës intelektuale është ngritur dukshëm. Ndërkaq, në sferën e bashkëpunimit ndërkombëtar në këtë fushë janë nënshkruar marrëveshje me Zyrën e Pronësisë Industriale të Republikës së Kroacisë dhe Maqedonisë.

Pronësia intelektuale, përfshirë pronësinë industriale, dhe të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera të përafërta, përkundër progresit të shënuar në disa sfera të saj, duhet të zhvillohet dhe rregullohet edhe më tej, sidomos në sferat e mbuluara nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen esaj. Infrastruktura ligjore¹¹ që rregullon këtë fushë, mbetet të plotësohet, ku përveç ligjeve në fuqi pritet të aprovohen edhe ligje të reja dhe të ndryshohet një pjesë e legjislacionit në fuqi. Sfidë tjetër me rëndësi, është edhe plotësimi i stafit të punësuar në institucionet përgjegjëse dhe/ose bashkëpërgjegjëse, ku përkundër rekrutimeve të konsiderueshme e kryesisht teknike, është mjaft e dukshme nevoja për rekrutim të stafit të kualifikuar në degët e ndryshme të kësaj fushe, si dhe ngritja profesionale e stafit ekzistues. Për më shumë, përballja me vëllimin e kërkesave për mbrojtje të objekteve të pronës industriale dhe aplikimi i mbrojtjes së paraparë me ligjet në fuqi, mbetet edhe më tutje sfidë për të gjitha institucionet e përfshira.

Me qëllim të adresimit të sfidave të identifikuara në këtë fushë, ky Plan parasheh përmirësimin e kornizës ligjore¹², ashtu që të vazhdohet rregullimi i mëtutjeshëm i fushës dhe mbrojtja më efikase e autorëve/pronarëve, dhe me qëllim të përafrimit me legjislacionin e BE-së. Poashtu, është paraparë që të adoptohen klasifikatorët ndërkombëtarë¹³ të cilët fuqizojnë të drejtat pronësore intelektuale, ku edhe do të organizohen trajnime, seminare dhe punëtori të ndryshme informuese për publikun mbi rëndësinë dhe vlerat e mbrojtjes së Pronës Intelektuale, e ky objektiv do të jetë i

⁹ ZPII, MKRS, PK, DK, MD etj.

¹⁰ Gjykatat, DK.

¹¹ Në vitin 2010 është aprovuar edhe Ligji për Topografi dhe Qarqe të Integruara

¹² Ligji për Treguesit Gjeografik, Ligji për Markat Tregtare, Ligji për Patenta dhe Ligji për Dizajn Industrial

¹³ Klasifikatorët e: Nices, Vjenës dhe Lokarnos

përkrahur edhe me fushata mediale. Në këtë drejtim, parashihet edhe themelimi i Këshillit Kombëtar për Pronësi Intelektuale dhe funksionalizimi i tij, i cili do të avancojë dukshëm fushën në fjalë dhe do të ndikojë në rritjen e bashkëpunimi t ndër-institucional në mes të Institucioneve relevante; si dhe, do të realizohet nënshkrimi i memorandumit në mes të institucioneve administruese dhe zbatuese të të drejtave mbi objektet e pronës intelektuale (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 62 dhe 130).

g. Punësimi dhe politikat sociale

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), gjatë vitit 2010 ka vazhduar me adresimin e sfidave të punësimit. Miratimi i Ligjit të Punës, Ligjit për Grevat dhe marrëveshja e mirëkuptimit për transferi min e kompetencave nga niveli lokal rregullojnë bazën ligjore në fushën e punës dhe mirëqenies sociale.

Për vitin 2010, fokusi kryesisht ka qenë në ngritjen e kapaciteteve dhe cilësisë së shërbimeve publike, sociale dhe të punësimit. Është shënuar progres në përmirësimin dhe funksionalizimin e bazës së të dhënave për centralizimin e sistemit informativ të punësimit duke përfshirë pastrimin e regjistrit të punëkërkuësve. Për më shumë, me mbështetjen e Komisionit Evropian MPMS ka vazhduar ofrimin e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve të abuzuar. Gjithashtu është përmirësuar korniza e legjislacionit sekondar me miratimin e dy udhëzimeve administrative për ofrimin e shërbimeve në komunitet/familje për personat e moshuar dhe me nevoja të veçanta. Ndërsa në kuadër të ripërtëritjeve të marrëveshjeve ndërshtetërore për sigurimet sociale dhe invalide, MPMS nëpërmjet grupit punues për këtë qëllim ka arritur të zhvillojë takimet e para me shtetet relevante me qëllim të definimit të çështjeve lidhur me sigurimet sociale.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2010 është shënuar progres pas miratimit të programit zhvillimor të punësimit të qëndrueshëm me qëllim të rritjes së punësimit përmes punëve publike. Strategjia e punësimit 2010-2012, Lëjji për Aftësim Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara , regjistrimi i të papunëve si dhe ndërmjetësimi në punësim kanë pasur një ndikim pozitiv në tërësinë e punës. Ndërsa miratimi i ligjit mbi grevat ka përmirësuar dialogun social. Edhe pse i kufizuar, progres ka pasur në aspektin e harmonizimit me standardet evropiane në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë.

Me gjithë progresin e shënuar, sfida në sektorin e punësimit mbetet rishikimi i draft-dokumentit të Letrës së Bardhë për Politika Sociale si dhe krijimi i një formule të financimit për financimin e shërbimeve sociale dhe familjare. . Me mënyre që legjislacioni relevant të implementohet, mbetet sfida ngritja e kapaciteteve të inspektoratit të punës, duke përfshirë edhe komunat e reja. Në fushën e mundësive dhe të drejtave të barabarta për punë, zbatim

Me qellim të adresimit të sfidave në sektorin e punësimit dhe çështjeve sociale, PVPE-e parasheh masat që duhet të ndërmerren për vitin në vijim. Përmirësimi i kornizës ligjore dhe asaj të politikave në fushën e mbrotjes sociale dhe të punësimit mbetet prioritet. Gjithashtu, ngritja e nivelit të shërbimeve, kapaciteteve institucionale në fushën e ofrimit të shërbimeve. Ndërsa objektiva kryesore për këtë vit për Qeverinë e Republikës së Kosovës në fushën e shëndetësisë janë ngritja e kapaciteteve institucionale në fushën e shërbimeve shëndetësore dhe përmirësimi i kornizës ligjore dhe asaj të politikave në fushën e shërbimeve shëndetësore.

Obligimet që dalin nga PVPE e vitit 2011 në fushën e punësimit dhe çështjeve sociale do të ndërlidhen me hartimin e legjislacionit se kondar në mënyrë që ligjet e aprovuara të bëhen funksionale dhe të arrihet implementimi i tyre (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 63-66)

h. Arsimi dhe kërkimet

Në vitin 2010 arsimi ka qenë ndër prioritetet kryesore të qeverise, duke synuar një arsim më gjithëpërfshirës, cilësorë dhe të barabartë për të gjithë.

Në vitin 2010 MASHT-i ka vazhduar me krijim in e infrastrukturës shkollore adekuate. Reformat në arsim kanë vazhduar përmes rishikimit të Kornizës së Kurrikulës të Kosovës e cila ka kaluar nëpër procesin ediskutimit publik nëpër komuna. Kosova ka zhvilluar dhe miratuar kurrikulën e saj të pa rë për gjuhën, historinë dhe kulturën Rome për shkollat fillore. Legjislacioni primar dhe sekondar është përforcuar përmes miratimit të ligjeve dhe dokumenteve strategjike.¹⁴ Shkenca dhe hulumtimi janë bërë prioritet për MASHT-in e cila ka hartuar Programin Kombëtar të Shkencës dhe ka ndarë një fond të veçantë për shkencë në shumë prej 1 milion EUR. Më tej është themeluar Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve si dhe është funksionalizuar Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional.

Përkundër progresit të shënuar gjatë vitit 2010, ende mbetin sfida me të cilat ballafaqohet arsimi dhe hulumtimi. Ndonës e investimeve kapitale gjatë vitit 2010 u është kushtuar rëndësi e veçantë, Raporti i Progresit i vitit 2010 e paraqet si sfide mësimin me ndërrime të shumta brenda ditës. Këshilli për Arsim dhe Aftësim Profesional është funksionalizuar por mungojnë kapacitetet e duhura për t'u bërë ky këshill tërësisht funksional. Trajnimi i mësimitdhënësve në përputhje me kurrikulën e re të zhvilluar në vitin 2010 është sfida tjetër e identifikuar në Raportin e Progresit. Përkundër asaj që Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është themeluar, mungojnë burimet njerëzore në nivelin komunal. Përderis a në fushën e shkencës duhet të rriten kapacitetet hulumtuese të universiteteve dhe instituteve kërkimore.

Plani i Veprimit të Partneritetit Evropian i vitit 2011 adreson sfidat kyçe me të cilat përballlet sektori i arsimit. Edhe në vitin 2011 do të vazhdohet me ndërtimin e infrastrukturës, duke adresuar kështu problemin e ndërrimeve të shumëfishta nëpër

¹⁴ Përfshirë ligjin për Arsimin Para-Universitar, Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë 2011-2016, Programin Kombëtar për Hulumtim, Planin Strategjik për Përfshirjen e Fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin para-universitar 2010-2015, Planin Individual të Edukimit etj.

shkolla. Edhe më tej do të vazhdohet me trajnimin e mësimeve për të adresuar mungesën e kapaciteteve të Këshillit për Arsimin Profesional. Përderisa korniza Ligjore do të vazhdojë të përforcohet me hartimin e udhëzimeve të reja administrative. Gjithashtu gjatë vitit 2011 planifikohet të rritet numri i përfituesve nga programet e ndryshme për arsimin e lartë dhe projekteve të ndryshme shkencore përmes programeve CEEPUS, TEMPUS, ERASMUR. Me qëllim të përmirësimit të cilësisë në

b. Bujqësia dhe peshkataria

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në Kosovë i cili gjeneron një sasi të konsiderueshme të prodhimit dhe të punësimit. Gjatë vitit 2010 MBPZHR ka plotësuar kornizën ligjore primare përmes miratimit të tri ligjeve bazike; atë për pyjet, për ujitjen e tokave bujqësore dhe për blegtorinë e Kosovës. Më tej është plotësuar gjithashtu edhe legjislacioni sekondar për implementimin e Ligjit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural me miratimin e 10 udhëzimeve administrative¹⁵. Në pajtim me Projektligjin për ndryshimin e Ligjit për Pyje është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit për decentralizimin e kompetencave për mbrojtjen dhe licencimin e pyjeve në 37 komuna.

Rritja e produktivitetit në sektorin e bujqësisë, është bërë përmes menaxhimit të burimeve të ujit për bujqësinë, investimeve në sistemet e përgjithshme të ujitjes (niveli primar dhe sekondar) si dhe në nivelin e fermës. Është bërë përmirësimi i përpunimit dhe tregtimit të produkteve bujqësore, duke promovuar prodhimet me vlerë të lartë që përmbushin standardet ndërkombëtare të higjienës, sigurisë dhe cilësisë së ushqimit për konsumatorët. Gjithashtu është përmirësuar menaxhimi i burimeve natyrore përmes pyllëzimit në tokat pyjore/bujqësore me vlerë të ulët të prodhimit bujqësor dhe në tokat pyjore ekzistuese. Më tej është arritur të implementohet Plani për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2007-2013 dhe janë implemtuar skemat mbështetëse, përmes pagesave direkte/subvencioneve për fermerët në sektorin e blegtorisë dhe hortikulturës dhe janë ngritur kapacitetet e fermerëve në përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe përdorimin e preparateve kimike. Më tej gjithashtu është zhvilluar regjistri i vreshtave për tërë rajonin vreshtar të Kosovës.

Përkundër progresit në fushën e pylltarisë, megjithatë ka vështirësi në implementimin e Ligjit të ri për Pyjet sidomos në drejtim të aplikimit të masave ndëshkimore të cilat varen edhe nga efikasiteti i organeve policore, të gjyqësisë dhe prokurorisë. Sfidë në sektorin e bujqësisë dhe pylltarisë mbetet edhe mbrojtja e tokës bujqësore dhe tokës pyjore nga ndërrimi i dëstinitimit të tyre në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi si dhe nga shfrytëzimi i gurorëve dhe zhavorrit po ashtu në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, e kjo si pasojë e mos koordinimit të duhur në mes të institucioneve qendrore/lokale dhe gjykatave.

Objektiv kryesor në këtë fushë do të jetë plotësimi i kornizës ligjore primare dhe përafrimit të legjislacionit ekzistues me *acquis*, si dhe plotësimi i legjislacionit sekondar në harmoni me rregulloret e BE-së në fushën e prodhimtarisë bimërore, zhvillimin rural dhe në promovimin e produkteve bujqësore. Po ashtu do të zhvillohen politikat për reformën e qëndrueshme të tokës duke miratuar strategjinë për rregullimin e tokave, krijimit të sistemit të informacionit për tokat e ndotura, sistemit të informacionit të thjeshtëzuar si dhe krijimin e infrastruktu rës ligjore për reformën e qëndrueshme të tokave. Më tej panifikohet të krijohet regjisi tri i fermave i cili do të mundësojë ndarjen e granteve dhe subvencioneve të titullarët e vërtetë të pronave. Ky plan gjithashtu

¹⁵ UA për Themelimin e Njësisë së Pagesave; UA për Masat dhe Kriteret e Përkrahjes në Bujqësi dhe Zhvillim Rural; UA për Pagesa Direkte; UA për Mbrojtjen e Pyjeve; UA për Themelimin, Përgjegjësitë, Funkcionet dhe Organizimin e APK-së; UA për Mënyrën dhe Procedurat e Shitjes së Trungjeve Pyjore; UA për Procedurat e Dhënies së Lejeve për Prerje etj.

parasheh ngritjen e kapaciteteve të teknologjisë informative për parcelat e tokës (LPIS) dhe për modelet e planifikimit hapësinor (GIS , pilot projekt). Gjithashtu do të bëhet inventarizimi, vlerësimi, monitorimi dhe krijimi i bazës së të dhënave për tokat e ndotura në Kosovë.

Në zbatim të procesit të decentralizimit të kompetencave të menaxhimit të pyjeve, pyjet dhe tokat pyjore do të menaxhohen përmes zhvillimit dhe fuqizimit të një kornize mbështetëse institucionale dhe rregullative pavarësisht nga pronësia, bazuar në principet e mbrojtjes dhe parandalimit të pr erjeve, konservimit biologjik dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekologjik. Kjo do të arrihet përmes miratimit të Ligjit të ri për Pyjet dhe akteve nënligjore. Do të vazhdohet me pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura të pyjeve si dhe do të merren masat parandaluese të shkatërrimit të pyjeve nga prerjet e paligjshme dhe nga shfrytëzimi i gurorëve dhe zhavorrit pa kritere. Rëndësi të veçantë do t'i jepet edhe hartimit të programit zhvillimor të gj uetisë dhe strategjisë për zhvillimin e ekoturizmit në Kosovë.

Në kuadër të promovimit të produkteve ve ndore dhe praktikave të mira bujqësore si dhe sensibilizimin e e opinionit për mbrojtjen e pyjeve parashihen trajnime për fermerë dhe shitës të preparateve kimike në lidhje me aplikimin dhe përdorimin e tyre (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 136, 138, 139)

Siguria e ushqimit dhe veterinaria

Në sferën e sigurisë së ushqimit, gjatë vitit 2010 është arritur të qartësohen kompetencat në mes të nivelit qendror dhe atij lokal përmes nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në mes të akterëve relevant në këtë fushë¹⁶ sa i përket transferimit të inspektorëve komunal (veterinar, fitosanitar dhe sanitar) në kuadër të AUVK-së. Poashtu Qeveria e Republikës së Kosovë ka përmirësuar kornizën ligjore për funksionalizimin e AUVK-së përmes miratimit të tri rregulloreve ¹⁷. Për më tepër, AUVK-ja ka organizuar kampanjën informative në media të shkruara dhe elektronike duke përfshirë edhe mediat e minoriteteve me qëllim të njoftimit të popullatës për rifreskimin e të dhënave lidhur me gjendjen e fondit blegtoral si dhe ri-regjistrimin e fermave në sistemin Inter Trace.

Sa i përket identifikimit, regjistrimit dhe kontrollit të lëvizjes së kafshëve (ruminantëve të vegjël) është bërë rifreskimi i të dhënave për disa ferma, ndërsa në vitin 2011 planifikohet të sigurohet një sistem i ri operativ i cili do të identifikoj regjistrimin e kafshëve përmes sistemit GIS. Po ashtu është arritur që të funksionalizohet Laboratori i Ushqimit i cili do të ketë ndikim pozitiv në të gjitha fushat e punës (sigurimi i ushqimit, kontrolli i ushqimit, monitorimi i ushqimit, etj.)

mungesa e objektit për riciklimin e kufo mave të kafshëve si dhe transpozimi i rregulloreve të Pakos Higjienike të Ushqimit.

Me qëllim të adresimit të sfidave në sferën e sigurisë së ushqimit, AUVK-j i ka paraparë disa veprime me qëllim të përmirësimit të gjendjes së këtij sektori. Veprimet në fushën e sigurisë së ushqimit në kuadër të PVPE2011 përfshijnë hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore për aditivët në ushqim, kontrollin kufitar dhe të brendshëm të ushqimit me origjinë bimore. Më tej plani parasheh regjistrimin, evidentimin dhe matrikulimin e kafshëve në tërë territorin e Kosovës dhe azhurnimin e të dhënave në bazën qendrore të të dhënave. Përveç kësaj gjithashtu parashihet edhe transpozimi i Pakos Higjienike të Ushqimit si dhe forcimi dhe përmirësimi i mëtutjeshëm i ndërmarrjeve agro-ushqimore (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 74, 75 dhe 137)

c. Mjedisi

Sektori i mjedisit ka vazhduar të plotësoj bazën ligjore përmes së cilës funksionon, duke arritur progres substancial në fushën e legjislacionit horizontal. Miratimi i ligjeve si ai i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis; Ligjit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor; Ligjit mbi Mbrojtjen nga Ndotja e Ajrit dhe Implementimin e Masave për të Monitoruar Shkarkimin e Gazrave nga Burimet Mobile si dhe miratimi i Ligjit mbi Mbrojtjen e Natyrës; Ligjit mbi Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes, e mundësojnë përafrimin e mëtejme të legjislacionit nacional me kapitullin e mjedisit të *acquis communautaire*. Kështu, është shënuar progres edhe nëpërforsimin e institucioneve duke themeluar Bordin Këshillues për Mbrojtjen e Mjedisit i cili ka për detyrë dhënien e këshillave Kuvendit të Kosovës dhe MMPH-së për çështje mjedisore. Në kuadër të procesit të rishikimit dhe përmirësimit të legjislacionit sekondar për fushën e mjedisit dhe mbrojtjes hapësinore, është shënuar progres në miratimin e një numri udhëzimesh administrative në fushën e mjedisit dhe planifikimit hapsinor..

Për më tepër, është intensifikuar më tej komunikimi dhe bashkëpunimi me shoqërinë civile. Mbi 20% të projekteve të parapara në planin e veprimit për mjedis janë realizuar me pjesëmarrjen e shoqërisë civile. Realizimi i Projektit Rajonal 'Paketa e Gjelbër' shënon progres duke përmirësuar bashkëpunimin me shoqërinë civile si dhe institucionet relevante për adresimin e sfidave afatgjata në fushën e edukimit në sektorin e mjedisit. Në anën tjetër, gjatë vitit 2010 është shënuar progres edhe në ngritjen e kapaciteteve njerëzore duke plotësuar 20 pozita si dhe duke siguruar trajnime profesionale për stafin përgjegjës.

Me gjithë progresin e shënuar, sektori i mjedisit përballet me sfida sidomos kur flasim për implementimin dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor i cili mbetet problematik. Përpjekje të mëtejme janë të nevojshme për të themeluar një infrastrukturë administrative dhe institucionale efektive dhe për të përmirësuar kanalet e bashkërendimit mes institucioneve me përgjegjësi mjedisore në të gjitha nivelet dhe me shoqërinë civile. Për më tepër, sektori i mjedisit si sfida për adresimin e problemeve mjedisore ka para vetës ngritjen e kapaciteteve njerëzore. Gjithashtu shkalla e faturimit dhe inkasimit për shërbime të ujit dhe të mbeturinave mbetet sfida e cila kërkon adresim nga disa institucione përgjegjëse.

Në përpjekje të adresimit të këtyre sfidave, ky Plan parasheh të ndërmerren masa për përmirësimin e kornizës legjislative në fushën e mjedisit, hartimin e politikave/strategjive në pajtim me prioritetet nacionale dhe standardet evropiane duke ngritur kapacitetet njerëzore. Plani adreson edhe fuqizimin e inspektoratit me qëllim të arritjeve të rezultateve konkrete përmes implementimit të ligjeve. Si rezultat, nga ky Plan pritet forcimi i rolit të institucioneve për

rrugëve ekzistuese. Duhet të përshpejtohen hapat drejt themelimit të agjencive rregullatore në mënyre që të përshpejtohet ritmi i implementimit të standardeve të BE-së nga ana e Kosovës. Për më tepër, vëmendje veçantë duhet t'u kushtohet zhvillimit të strategjive dhe politikave të transportit dhe ndërmarrjes së hapave konkret për përmirësimin e sigurisë rrugore. Transporti ajror në Kosovë vazhdon të ballafaqohet me nevojën e forcimit të kapaciteteve institucionale dhe tërheqjes së më shumë profesionistëve në rregullimin e transportit ajror për implementimin standardeve të aviacionit në përputhje me kërkesat e ECAA-së. Po ashtu edhe hekurudhat e Kosovës ende përballen me nevojën e ngritjes së kapaciteteve profesionale e teknike dhe rritjes së pavarësisë menaxheriale.

Megjithatë, ky plan parasheh aktivitete konkrete për adresimin e sidave të lartpërmendura. Qeveria e Kosovës do të vazhdoj me realizimin e projektit R7¹⁸ si dhe me përmirësimin e gjithëmbarshtëm e infrastrukturës rrugore dhe mirëmbajtjen e tyre. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal në fushën e transportit të udhëtarëve dhe mallrave planifikohet nënshkrimi i marrëveshjeve me Shqipërinë dhe Malin e Zi dhe marrëveshjeve tjera bilaterale me shtetet e rajonit e më gjerë. Ndërsa sa i përket përmirësimit të menaxhimit të hekurudhës e të Kosovës ky plan parasheh miratimin e ligjit të përgjithshëm në përputhje me direktivat evropiane dhe finalizimin e procesit të ndarjes së hekurudhës të Kosovës në INFRAKOS (Infrastrukturë) dhe TRAINKOS (operimi me trena). Ndërkaq, me miratimin e ligjit për ndihmën shtetërore do të mundësohet edhe fillimi i implementimit të fazës së parë kalimtare të Marrëveshjes Evropiane për një Zonë të Përbashkët të Aviacionit (ECAA) (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 49, 53, 81-84, 86, 89 dhe 143-145)

e. Energjia

Për zhvillim më të mirë të sektorit të energjisë, Qeveria e Kosovës ka plotësuar më tutje legjislationin dhe strategjinë për energji 2009-2018 të aprovuar në Kuend duke definuar projektet zhvillimore të sektorit. Kjo strategji dhe këto ligje synojnë zhvillimin e këtij sektori, zotim ky i cili gjithnjë bëhet në përputhje me *acquis* të BE-së, përkatësisht kriteret të dala nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (TKE). Andaj, një sinergji e tillë ka rezultuar në miratimin e një sërë ligjesh sikurse është ai për energjinë, rregullatorin e energjisë, energjinë elektrike, për minierat dhe mineralet, ligji për ngrohjen qendrore dhe ligji për gazin natyror. Plotësim i mëtutjeshëm i legjislationit është bërë përmes harmonizimit të tij me direktivat e caktuara, pra kompletimi i Roadmap-it për implementimin e kërkesave të direktivave për shfrytëzuesit fundor dhe shërbime të energjisë¹⁹, performanca e energjisë në ndërtesa²⁰ si dhe ajo për etiketimin i pajisjeve elektrike²¹.

Më tutje, Qeveria e Kosovës vazhdon të jetë e përkushtuar në trajtimin e njërës nga sfidat më të mëdha; furnizimin e pandërprerë me energji, pasuar me segmentet si faturimi dhe inkasimi i energjisë elektrike të shpenzuar. Në këto të fundit, krahasuar me

¹⁸ Gjatë vitit 2011 pritet që punimet të përfundojnë në segmentet 1-3 (Vermicë- Suharekë 34 km)

¹⁹ Direktiva 2006/32/EC

²⁰ Direktiva 2002/91/EC

²¹ Direktiva 92/75/EEC

vitin 2009, vitin e kaluar kishte rritje në pranim (në MW) të energjisë elektrike me rritje për 5.3%, faturim (në MW) të energjisë së pranuar për 9.87% ose 2.07 % në EUR, inkasim për 10,96% si dhe rritje të numrit të transaksioneve për 24.78%.

Sidoqoftë, përkundër punës dhe përpjekjeve të vazhdueshme pagesa e pakënaqshme e energjisë së shpenzuar (dhe tarifat pa kthim kostoje) si dhe humbjet e energjisë, ato teknike dhe komerciale, shndërrojnë Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) në njërin nga barrët e mëdha si për sektorin, ashtu edhe për buxhetin e Republikës së Kosovës. Për më tepër, këto bëjnë që kërkesa për energji të rritet në mënyrë të pakontrolluar dhe të papërbalueshme, e si pasojë të aplikohen reduktime në furnizimin me energji elektrike. Që këto çështje të eliminohen në një të ardhme të afërt, Qeveria e Kosovës është duke punuar drejt ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese, përkatësisht Termocentrali Kosova e Re dhe Hidrocentrali i Zhurit i cili është në fazën e koncesionimit, kapacitete këto të mjaftueshme jo vetëm për tregun e brendshëm por edhe atë rajonal. Por, përderisa të arrihet kjo Qeveria e Kosovës në ndërkohë ka marrë hapa/masat për energjinë në dispozicion, masa të cilat do të shërbejnë si tani e edhe më tutje për kursimin dhe eficiencën e energjisë. Hapa të tillë janë marrë në të gjitha fushat dhe mënyrat, si për vetëdijesimin publik ashtu edhe në vendosjen e masave fizike.

Përpos të lartë përmendurave, sfidë e vazhdueshme për Kosovën, e në veçanti për Operatorin e Sistemit, Tregut dhe Transmisionit është pengesa e drejtpërdrejtë që bëhet nga Operatori Serb i Transmisionit (EMS). Më saktësisht, ky Operator lë jashtë Operatorin Kosovar nga Asociacionet Evropiane dhe mekanizmat rajonal, duke i prezantuar asetet transmetuese të Kosovës si të vetat dhe duke përfitur kështu në mënyrë të paligjshme nga transiti i energjisë elektrike nëpër rrjetin transmetues të Kosovës dhe nga alokimi i kapaciteteve interkonektive të Kosovës. Për këtë arsye dhe duke u mbështetur në Rregullat për zgjidhjen e kontestit në kuadër të TKE, KOSTT ka ngritur ankesë kundër Republikës së Serbisë për shkelje të Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Sekretariati i KE-së i ka dërguar Republikës së Serbisë letër të hapur ku shpreh një qëndrim që Republika e Serbisë kabërë shkelje të provizioneve të Traktatit. Mbetet që SKE të angazhohet më tutje në zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje. Andaj, përderisa ekziston ky diskriminim, komp ensimet dhe humbjet e tilla zbatohen tek konsumatorët.

Siç dihet Kosova është anëtare e TKE-së, dhe është zotuar për përmbushjen e të gjitha obligimeve që rrjedhin nga TKE, përmes harmonizimit të objektivave të veta me kërkesat e këtij Traktati të cilat i ka paraqitur në Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës 2009-2018. Si pjesë e procesit të integritit evropian, Plani i Veprimit për Partneritet Evropian (PVPE) është në përputhje me këto obligime dhe me objektiva

zhvillimin e kapaciteteve transmetuese e të gjitha niveleve (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 87, 88, 146 dhe 147).

f. Shoqëria informative dhe mediat

Sa i përket progresit në sektorin e telekomunikacionit, përkatësisht në fushën e legjislacionit primar, gjatë vitit të kaluar është miratuar ligji për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetik si dhe ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale i cili përcakton të drejtat, përgjegjësitë, parimet dhe masat lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale.

Hapat pozitiv që ka realizuar ART-ja gjatë vitit 2010 janë edhe miratimi i vendimit për Krijimin e Njës Shkëmbyese të Internetit (Internet Exchange Point - IXP), si dhe ka nxjerr urdhëresën për vendosjen e kushteve shtesë për licencat dhe autorizimet për ofruesit e shërbimeve të internetit.

Raporti i Progresit 2010 për Kosovën vlerëson se ka pasur progres substancial në politikat audiovizuale dhe mediat, kryesisht në përmirësimin e fushës së financimit dhe kapaciteteve administrative për Komisionin e Pavarur për Media (KPM). Për më tepër, KPM-ja ka kompletuar procesin e ri-licencimit të transmetuesve duke përmbushur obligimin ligjor që njëkohësisht ka mundësuar zgjerimin e zonës së mbulueshmërisë për subjektet transmetuese, respektivisht zgjerimit të audiencës. Funksionimi i Shoqatës së Pavarur të Mediave Transmetuese të Kosovës, e cila përfshinë të gjitha mediat elektronike, si shqiptare ashtu edhe të sërbeve të Kosovës, është vlerësuar si një shembull i bashkëpunimit konstruktiv mes komuniteteve.

Si rezultat i mungesës së burimeve njerëzore, ekspertëve dhe kufizimet financiare, ART-ja përballlet me kufizime substanciale në përgatitjen dhe implementimin e legjislacionit duke pamundësuar kryerjen e detyrave të veta plotësisht si një autoritet i pavarur rregullativ. Ndërkaq, pezullimi i kuotave të pagesës nga publiku për RTK-në, ka pamundësuar që transmetuesi publik të ndante 5% të kësaj pagese për fondin e mbështetjes së mediave të pakicave, shumetnike dhe të mediave tjera speciale, siç kërkohet me ligj.

Megjithatë, hapa të rëndësishëm pritet të ndërmerren për adresimin e sfidave në sektorin e shoqërisë informative dhe mediave gjatë vitit 2011. Nga fusha e legjislacionit primar, pritet miratimi i Ligjit për Komunikime Elektronike, amendamenti i ligjit për KPM-në, ndërsa sa i përket qartësisht të dispozitave penale ndaj shpifjes, me amendamentimin e Kodit Penal të Kosovës do të zgjidhen edhe paqartësitë ekzistuese ligjore në mes të Ligjit mbi Shpifjet dhe Fyerjet dhe Kodit Penal.

Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të ART-së, pritet të rekrutohet stafi i ri në mënyrë që të fuqizohet pavarësia operacionale e këtij rregullatori. Në anën tjetër pritet që miratimi i Ligjit për RTK-në të forcëtojë pavarësinë e transmetuesit publik dhe të zgjidh përfundimisht qëndrueshmërinë e tij financiare. Ndërsa në kuadër të procesit të privatizimit të ndërmarrjeve publike me interes nacional, ka filluar procesi i privatizimit

të PTK-s dhe pritet të përfundojë brenda vitit 2011 (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 37, 89 dhe 148).

g. Kontrolli financiar

Gjatë vitit 2010, Qeveria e Kosovës, kavazhduar me përforsimin e mekanizmave institucional dhe ligjorë që të forcojnë kontrollin financiar. Në fushën e kontrollit të brendshëm të financave publike (KBFP) është punuar në plotësimin e legjislacionit sekondar për të mbështetur zbatimin e Ligj

Për më tepër, për të nxitur investimet e jashtme dhe për të përmirësuar menaxhimin e aseteve, në fokus të veçantë gjatë vitit 2011, do të jetë krijimi i mundësive më të mira për partneritetet publiko-private duke siguruar kompatibilitet me kornizën legislative të BE-së mbi koncesionet.

Plani i këtij viti parasheh forcimin e kapaciteteve operative si dhe pavarësimin financiar dhe operacional të ZAP-së, duke ngritur kapacitetet administrative dhe njerëzore si dhe forcimin e legjislacionit dhe mundësimin e bashkëpunimit me organizatat tjera ndërkombëtare (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 83, 92, 149,150)

h. Statistikat

Është shënuar nivel i konsiderueshëm i progresit në kompletimin e kornizës ligjore me miratimin e Ligjit për regjistrimin e popullsisë së, të ekonomive familjare dhe të banesave. Me këtë ligj përcaktohen mënyrat e organizimit dhe zhvillimit të procesit të regjistrimit të popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave në Kosovë. Lidhur me regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave janë ngritur të gjitha grupet profesionale dhe teknike si me ekspert të brendshëm poashtu edhe me ekspert ndërkombëtar me përkrahje të Misionit Monitorues Ndërkombëtar si dhe Eurostat-it për implementimin e Planit të Regjistrimit të Popullsisë.

Në fushën e infrastrukturës së statistikave gjithashtu është shënuar progres i konsiderueshëm, me ç'rast është përmirësuar bashkëpunimi me prodhuesit dhe shfrytëzuesit e caktuar të statistikave dhe se në të njëjtën kohë është nënshkruar MoU me Ministrinë e Bujqësisë. Banka Qendrore ka filluar publikimin e bilancit të pagesave në baza tremujore të cilat japin informata më të thukëta dhe njëherit sigurojnë përcjellje më të mirë të pagesave në Kosovë. Sa i përket statistikave makroekonomike ka pasur përparim të dukshëm duke mundësuar që indeksi i çmimeve të konsumit të rifreskohet.

Edhe pse ka pasur një numër të rëndësishëm masash të ndërmarra, sfida në këtë sektor mbeten përmirësimi i burimeve njerëzore dhe financiare të ESK-së, ngritja e kapaciteteve njerëzore në departamentin e TI-së, rritja e nivelit të progresit në klasifikimet dhe regjistrat. Ndërsa autoritetet doganore duhet të përmirësojnë në mënyrë të konsiderueshme cilësinë e të dhënave të tregtisë së jashtme.

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave të mbetura, Plani i tanishëm i Partneritetit Evropian parasheh një sërë masash të mëtejme. ESK parasheh përforcimin e statistikave të biznesit dhe ato makroekonomike, aplikimin e NACE Rev. 2 si dhe standardizimin e të dhënave statistikore sipas kërkesave të Eurostatit (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioriteti 94).

3.3.3. DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA

a. Vizat, kufijtë, azili dhe migrimi²²

Me hyrjen në fuqi të ligjeve kyçe dhe një numri aktesh nënligjore, legjislacioni kornizë dhe ai zbatues në këto fusha është kompletuar dhe vazhdon të avancohet. Sa i përket zhvillimit të kornizës së politikave dhe asaj institucionale, me miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Ri-integrimin e Personave të Riatdhesuar është kompletuar kjo kornizë, kurse në kontekstin e reformimit të strukturës së brendshme të MPB-së dhe PK-së janë qartësuar dhe ndarë saktësisht përgjegjësitë në mes të këtyre dy institucioneve. Më tej, me miratimin e Planit Zhvillimor të MPB-së, tashmë është vendosur një bazë solide për zhvillim institucional, në njërin anë, dhe zhvillim, zbatim e monitorim të politikave në këto fusha, në anën tjetër.

Megjithatë, nevojitet të vazhdojë përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit me *Acquis*, në veçanti në kontekstin e adresimit të prioriteve të Qeverisë për përmbushjen e kriterëve teknike për fillimin e dialogut për liberalizimin e vizave. Kjo përfshinë edhe harmonizimin e legjislacionit zbatues me legjislacionin kornizë të rishikuar dhe reflektimin e nevojës për plotësimin e kornizës së politikave dhe zbatimin e saj përmes legjislacionit përkatës. Sa i përket kësaj të fundit, mungesa e një regjimi vizash, e përgjegjësisë së plotë për kontrollin e kufijve të autoritetet vendore, e një sistemi adresash, por edhe sfidat sa i përket pronësisë vendore në politikë-bërje strategjike, reformimin e institucioneve e zhvillimin e kapaciteteve institucionale, dhe implementimi në pajtueshmëri të plotë me standardet evropiane, mbeten ndër çështjet prioritare që duhen adresuar.

Bazuar në këtë nivel të zhvillimeve dhe me qëllim të adresimit të këtyre dhe sfidave të tjera, gjatë periudhës në vijim autoritetet do të vazhdojnë me përafrimin e legjislacionit kornizë dhe atij zbatues me *Acquis* dhe me standardet evropiane. Masat në këtë nivel do të përqendrohen në çështjet kufitare, sigurinë e dokumenteve dhe zbatimin e politikës së vizave, e cila gjithashtu do të vendoset gjatë këtij viti. Edhe në nivelin e plotësimit të kornizës së politikave dhe zhvillimit institucional kërkohen ndërhyrje strategjike. Kjo me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, si dhe për shkak të shtimit të volumit të përgjegjësisë që janë në transferim e sipër te autoritetet vendore dhe nevojës për avancimin e bashkëpunimit me autoritetet e shteteve fqinje. Në këtë kontekst, PVPE 2011 parasheh ndërhyrje strategjike në nivelin e dokumenteve të politikave dhe planeve operacionale. Përveç kësaj, masat përkatëse gjithashtu synojnë ngritjen e kapaciteteve institucionale përmes investimeve kapitale, rekrutimeve shtesë (përfshirë transferimet e brendshme) e trajnimeve, me prioritet riatdhesimin dhe ri-integrimin e personave të riatdhesuar, çështjet kufitare dhe sigurinë e dokumenteve (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 95 – 98 dhe 152)

²² Një pasqyrë të plotë të kornizës legjislativë dhe institucionale në sektorin e Drejtësisë, Lirisë dhe Sigurisë e jep *Plani i Veprimit 2009 për Implementimin e Partneritetit Evropian për Kosovën*, fq. 122 – 129

b. Shpëlarja e parave

Sa i përket parandalimit dhe luftimit të shpëlarjes së parave, deri më tani është miratuar ligji përkatës kornizë, kurse përgjegjësitë për bërjen e politikave akoma janë në transferim e sipër nga EULEX-i në Njësinë e ardhshme të Inteligjencës Financiare, bazuar në Memorandumin përkatës, nga i cili ka rrjedhur udhërrëfyesi përkatës që parasheh përfundimin e këtij procesi br

ë r Administrimin e Pasurive të Konfiskuara dhe të zbatimit, PK-ja ka shënuar progres të konsiderueshëm në has operac ioneve hetuese, në bashkëpunim me *Task Forcën* speciale dhe EULEX

Përkundër këtyre të arritura ve, dy institucionet ekzekutive përgjegjëse akoma nuk janë funksionale, kurse kapacitetet e institucioneve

Me qëllim të adresimit të këtyre sfidave, PVPE 2c11 parasheh një sërë ndërhyrjesh strategjike që reflektojnë prioritetin që i japin autoriteteve vendore kompletimit dhe avancimit të mëtejshëm të kornizës ligjore, rregullative dhe asaj të politikave. Më tej, me rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe prokuror

c. Drogat

Sa i përket luftës kundër narkotikëve, pa

gjë që tregon për një nivel akoma të ulët të zbatimit të politikave strategjike të zhvilluara deri më tani.

Edhe në këtë fushë PVPE 2011 parasheh ndërhyrje strategjike në avancimin e kornizës ligjore dhe zhvillimin e mëtejshëm të kapaciteve institucionale për luftimin e drogave, me fokus në luftimin e trafikimit të tyre, përmes rekrutimeve, trajnimeve, si dhe avancimit të infrastrukturës së nevojshme teknike, si të agjencive ekzekutive të zbatimit të ligjit ashtu edhe të institucioneve gjyq

e. Luftimi i krimit dhe krimit të organizuar

Edhe në fushën e luftimit të krimit të organi zuar Kosova vazhdon të përballet me sfida. Përparimet kryesisht kanë të bëjnë me zhvillimin e mëtejshëm të bazës ligjore e të politikave dhe të ngritjes së kapaciteteve humane të agjencive të zbatimit të ligjit dhe institucioneve gjyqësore. Nga ana tjetër, zbatimi vazhdon të mbetet sfidues, e kjo është pasojë, mes tjerash, e një numri të konsiderueshëm sfidash e problemesh strukturale me të cilat përballen institucionet përgjegjëse. Ndër më kryesoret prej tyre përfshijnë mungesën e një kornize rregullative, të politikave e të infrastrukturës teknike të nevojshme, me një fjalë të një sistemi gjithëpërfshirës në mbështetje të hetimeve, i cili do të siguronte mbrojtjen e dëshmitarëve e të informatorëve por gjithashtu hetime efektive dhe në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut që janë në fuqi. Kjo gjithashtu përfshin sfida serioze sa u përket kapaciteteve institucionale, bashkëpunimit ndër-institucional e atij ndërkombëtar, kurse të tjera sfida kanë të bëjnë me përndjekjen e të dyshuarve dhe trajtimin e viktimave të krimit.

Ky Plan Veprimi parasheh një sërë ndërhyrjesh strategjike që synojnë adresimin e këtyre sfidave. Këto ndërhyrje fokusohen në avancimin e kornizës së politikave dhe të kapaciteteve institucionale për zbatimin e kornizës ligjore dhe të politikave dhe monitorimin e vlerësimin periodik të zbatimit të tyre, me prioritet parandalimin, hetimin dhe përndjekjen. Ato prekin të gjitha kategoritë e krimit të organizuar dhe të gjitha aspektet e parandalimit, hetimit e përndjekjes së tyre: kornizën ligjore e institucionale, vetëdijesimin e publikut, policinë e udhëhequr nga inteligjenca, aspektet gjyqësore të hetimit, sigurinë publikë dhe atë në komunitet, bashkëpunimin ndërkombëtar, si dhe aspektet infrastrukturore e teknike (për më shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 103 – 107, dhe 153 – 155).

f. Mbrojtja e të dhënave personale

Gjatë vitit 2010 është shënuar progres në avancimin e kornizës ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale, përmes miratimit të ligjit përkatës. Gjithashtu, janë bërë përpjekje për themelimin e Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përmes propozimit nga ana e Qeverisë, bërë Kuvendit për zyrtarët e lartë të këtij institucioni.

Sfidë në drejtim të përmirësimit të gjendjes së mbrojtjes së të dhënave personale në Kosovë, mbetet mos-themelimi i AKMDhP-së, sikurse edhe analizimi i përgjithshëm i legjislacionit përkatës për të parë mundësinë e rishikimit me qëllim harmonizimin me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Gjithashtu, problem mbetet edhe niveli i ulët i vetëdijesimit të qytetarëve rreth të drejtave të tyre në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale.

Përmes këtij Plani veprimi, mëtohet të adresohen këto sfida përmes masave për themelimin dhe funksionalizimin e AKMDhP-së, analizimit dhe rishikimit eventual të legjislacionit për harmonizim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe përmes masave për vetëdijesimin e mëtejshëm të qytetarëve rreth së drejtave të tyre për mbrojtjen e të dhënave të tyre personale (përmë shumë detaje shih tabelën e veprimeve, Prioritetet 108 dhe 157).

**4. MATRICA E VEPRIMEVE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR PARTNERITET
EVROPIAN 2011**

EPP Nr Vpn

Id

Id

AE

Id

Pg

Id
Mb

Din
Ri

Tb

BKK

Dd

Zd

1 0

2 0

3 0

3 1 3.1 Kompletimi i

- 4 2 4.2 Kompletimi i kornizës ligjore dhe institucionale për monitorimin e zbatimit të normave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut
1. Ligji për Mekanizmat për Bashkëpunim, Raportim dhe Promovim të të Drejtave të Njeriut në Kosovë i miratuar
 2. Kompetencat e institucioneve që merren me të drejtat e njeriut të harmonizuara (streamlined) në mes veti

4	5	4.4 Të përmirësohet zbatimi i kornizës ligjore anti-korrupsion	<p>1. Raporte për vlerësimin e zbatimit të legjislacionit anti-korrupsion (Ligjit për Agjencinë Kundër Korrupsion, Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Ligjit për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave të Zyrtarëve të Lartë Publike dhe Ligji për Financimin e Partive Politike)</p> <p>2. Strategjia dhe Plani i Veprimit kundër korrupsionit 2012 - 2017 e miratuar</p> <p>3. Raporte të rregullta tremujore mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit Anti-korrupsion (që mbulon të gjitha veprimet e parapara)</p> <p>4. Lista e zyrtarëve që kanë deklaruar pasurinë</p> <p>5. Numri i deklaratave të pasurisë që kanë kaluar procesin e verifikimit</p> <p>6. Përqindja e deklaratave të pasurisë në të cilat janë gjetur parregullsi</p> <p>7. Numri i deklaratave të pasurisë të publikuara</p> <p>8. Numri i rasteve të zgjidhura të konfliktit të interesit</p>	K4 - 2011	AKK	KQZ MD MPB	L. për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të dhuratave të zyrtareve të larte, dhe Ligji për Agjencinë kundër Korrupsionit, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Ligji për Financimin e Partive Politike, Strategjia dhe Plani i Veprimit Kundër Korrupsion	/	/	/	
4	6	4.5 Të përmirësohet më tej korniza ligjore dhe ajo e politikave për luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare	<p>1. Njëzet (20) UA për zbatimin e Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimit të Terrorizmit të miratuara</p> <p>2. Gjashtë (6) akte nënligjore për zbatimin e Ligjit për Menaxhimin e Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara të miratuara</p>	K4 - 2011	MEF	MD MPB MPB/PK DK BQK ATK KGJK PSH	Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit	/			

4	7	4.6 Ngritja dhe avancimi i kapaciteteve institucionale dhe teknike për zbatimin e kornizës ligjore dhe asaj të politikave për luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare	1. Drejtori i Njif-it i përzgjedhur 2. Staf i vendor i QIF/EULEX (16 zyrtarë) i transferuar në Njif/MEF 3. Arkiva e QIF/EULEX e transferuar në Njif/MEF 4. Një sistem i raportimit të detyrueshëm i zhvilluar dhe funksional 5. Shtatëmbëdhjetë (17) zyrtarë të rekrutuar në MD/AAPKS 6. Njëzet-e-tetë (28) zyrtarë të rekrutuar në DHEK/PK; katër (4) ekspertë të fushës dhe njëzet e katër (24) zyrtarë policorë - përmes transferimeve të brendshme 7. Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve përgjegjës për luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare 8. Katër (4) raporte tremujore të hartuara nga PK për secilën nga strategjitë dhe PV-të relevante për luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare (kundër krimit të organizuar, kundër korrupsionit, kundër terrorizmit, kundër drogave, kundër TQNJ) 9. Plani i Trajnimeve për Njif i hartuar dhe miratuar 10. Numri i trajnimeve të mbajtura për Njif/MEF 11. Pesëmbëdhjetë (15) trajnime për MD/AAPKS-në të mbajtura 12. Dyqind (200) zyrtarë policorë të trajnuar për hetimin e luftimin e krimeve ekonomike dhe financiare 13. Automjete dhe pajisje të tjera për MD/AAPKS të siguruar	K4 - 2012	MEF	MD MPB MPB/PK DK BQK ATK KGJK PSH	Ligjit për Parandalimin e Shpëlarjes së Parave dhe Financimin e Terrorizmit Strategjia dhe PV Kundër Korrupsionit 2011 - 2013 Plani i Trajnimeve të PK-së për 2011	/	/	/	
4	8	4.7 Zhvillimi i kapaciteteve të PK-së për implementimin e Strategjisë për Polici të Udhëhequr nga Inteligjenca (ILP)	1. Tri (3) vizita studimore për zyrtarë policorë mbi konceptin e ILP të ofruara 2. Dyqind e tridhjetë (230) zyrtarë policorë të trajnuar për hetimin dhe luftimin e krimit të organizuar 3. Katër (4) raporte për vlerësimin e implementimit të Strategjisë për Polici të Udhëhequr nga Inteligjenca (ILP) të hartuara 3. Avancimi i sistemit të TI-së për hetimin dhe luftimin e krimeve 4. SIPK/KPIS (Sistemi Informativ i Policisë së Kosovës) i ndërlidhur me bazat e të dhënave të MIK-ut, ARC-së, migracionit, vizave dhe SPIS	K4 - 2011	MPB	AKI	Plani i Punës i MPB-së për 2011 Strategjia kundër Krimit të Organizuar Trajnimeve të PK-së për 2011	/	/	/	
5	0	5. Të sigurohet qeverisje demokratike dhe bartje e shërbimeve publike tek të gjithë qytetarët e Kosovës, duke vendosur administratë publike përfaqësuese e cila të jetë jetë profesionale, e përgjegjshme, e arritshme dhe e liruar nga ndërhyrjet politike.									

5	1 5.1 Kompletimi i kornizës ligjore për Shërbimin Civil të Kosovës	1. Ligji mbi Qeverinë i miratuar. 2. Numri i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës të mirautara 3. Numri i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë të miratuar 4. Numri i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Qeverinë të mirautara 5. Numri i akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Administratën Shtetërore të mirautara	K4 - 2011	MAP	Kuvendi ZKM MEF	Plani i Punës MAP / 2011	/	/	/	/
5	2 5.2 Avancimi i sistemit të zhvillimit dhe menaxhimit të burimeve njerëzore, në përputhje me legjislacionin e ri për Shërbimin Civil të Kosovës	1. Baza e avancuar e të dhënave e instaluar dhe funksionale 2. Sistemi i avancuar i raportimit të rregullt tremujor te DASHC i vendosur 3. Raportet e rregullta vlerësuese të DASHC-së mbi Shërbimin Civil të publikuara 4. Numri i trajnimeve të mbajtura per HRM	K4 - 2011	MAP	/	/	/	/	/	/
5	3 5.3 Zbatimi i Strategjisë dhe PV për RAP	1. PV i miratuar 2. Raportet e rregullta mbi implementimin e Strategjisë dhe PV për RAP të hartuara dhe miratuara nga KNRAP 3. Vendimet e marra në KNRAP 4. Vendimet e buxhetuara të dala nga takimet e rregullta të KNRAP-it. 5. Numri i stafit të rekrutuar në DMRAPIE	K4 - 2011	MAP	KNRAP	/	/	/	/	/
5	4 5.4 Zhvillimi i një sistemi të planifikimit të integruar të politikave të Qeverisë	1. Rregullorja e re e Punës së Qeverisë e miratuar 2. Rregullorja për Zyrat për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave (ZIEKP) në kuadër të Ministrive të Linjës e miratuar 3. Grupi Drejtues për Planifikim të Integruar i formuar. 4. Doracaku për zhvillimin dhe hartimin e politikave e miratuar 5. Udhëzuesi për hartimin e dokumenteve strategjike të Qeverisë (përfshirë buxhetimin sipas këtij sistemi) të miratuar 6. Numri i stafit të trajnuar në ZPS/ZKM, DB/MEF, dhe ZIEKP në Ministrinë e Linjës	K4 - 2012	ZKM	MIE MEF IL	Plani i Punës së Qeverisë	/	/	/	/
6	0 6. Të avansohet reforma e vetë-qeverisjes dhe të ngriten kapacitetet administrative për të ndihmuar decentralizimin, duke i marrë parasysh synimet dhe interesat e të gjitha komuniteteve në Kosovë, të miratohet korniza									
6	1 6.1 Vazhdimi i procesit të decentralizimit	1. Komuna e Mitrovicës Veriore e themeluar 2. Mbartja e kompetencave e perfunduar; 3. Dokumentacioni nga Komuna amë e Gjilanit në Komunen e re të Parteshit e përfunduar	K4 - 2011	MAPL	Komunat	Plani i Veprimit per / Decentralizim	/	/	/	/

7 0

7	7.1 Përmirësimi i kornizës institucionale në fushën e mbrojtjes së minoriteteve	1. Zyret Komunale për Komunitete dhe Kthim në komunat e reja të themeluara dhe stafi përkatës i rekrutuar 2. Numri i trajnimeve të mbajtura për stafin e ZKKK-ve 3. Krijimi i databazës për komunitete	K4 - 2011	ZKM	MKK MAPL Komunat MPB	Plani i Veprimit për Decentralizim
---	---	--	-----------	-----	-------------------------------	------------------------------------

8	1	8.1 Përmirësimi i kornizës ligjore për respektimin e lirive fetare	1. Ligji për Liritë Fetare i amendamentuar 2. Aktet nënligjore të miratuara 3. Numri i Objekteve të Trashëgimisë Kulturore Fetare që u ofrohet sigurim nga PK	K4 - 2011	ZKM	MPB PK	/	/	/	/	
8	2	8.2 Plotësimi i kornizës ligjore dhe asaj të politikave në fushën e trashëgimisë kulturore	1. Ligji mbi Hocën e Madhe i miratuar 2. Ligji për Mbrojtjen mbi Zonën Historike të Prizrenit i miratuar 3. Dokumenti strategjik mbi konservimin e integruar të tërësive kulturore i miratuar	K4-2011	MMPH	Kuvendi, MKRS MAPL, Komuna e Rahovecit, Komuna e Prizrenit	Ligji për Trashëgiminë Kulturore	/	/	/	
9	0	9. Të krijohet një shoqëri e lirë nga diskriminimi i çfarëdo lloji, dhe të promovohet integrimi i grupeve të disavantazuara.									
9	1	9.1 Përditësimi i kornizës së politikave kundër Diskriminimit dhe ngritja e vetëdijes nëpërmjet promovimit të Ligjit Kundër Diskriminimit	1. Plani i Veprimit kundër Diskriminimit i përditësuar 2. Numri i aktiviteteve publike të organizuara (seminare, punëtori) 3. Fushata mediale të realizuara (spote televizive, etj)	K4 - 2011	ZKM	ML	Ligji Kundër Diskriminimit Nr.2004/32	/	/		
10	0	10. Të vazhdohet me forcimin e të drejtave pronësore, kornizës ligjore dhe qasja në gjykata, me vizion të promovimit të një mjedisi të përshtatshëm për biznes.									
10	1	10.1 Vendosija e kërkesave në shkallë të parë nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës	1. Numri i Kërkesave të vendosura nga Komisioni	K2 - 2011	AKProp	Gjykata Supreme e Kosovës (shkalla e dytë)	Ligji 03/L079 për amendamentimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50				/
10	2	10.2 Implementimi i vendimeve me kthimin e pronës, administrimi, aukcion, dëbim apo ndërmjetësim (numri i vendimeve të zbatuara)	1. Numri i vendimeve të zbatuara	K4 - 2011	AKProp	PK	Memorandumi i mirëkuptimit me PK				/
10	3	10.3 Administrimi i pronave dhe implementimi i skemës së qiradhënies	1. Numri i pronave të administruara dhe të dhëna me qira 2. Numri i pronave nën administrim të kthyera në riposedim pronarëve)	K4 - 2011	AKProp	Komunat dhe MEF	Ligji 03/L079 për amendamentimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50				/
PKB Sb											
PKB											
		1.1 Demokracia dhe Sundimi i Ligjit									
		1.1.1 Institucionet									
11	0	11. Të sigurohet funksionimi efektiv i Kuvendit dhe komisioneve të tij, i Qeverisë dhe komunave, përfshirë respektimin e plotë të të gjitha rregulloreve të punës, kodeve të mirsjelljes, si dhe të drejtave dhe interesave të të gjitha komuniteteve.									

